

V E N D I M
Nr. 49, datë 21.3.1994

**PER PERJASHTIMIN NGA TAKSAT DOGANORE TE MAKINERIVE, PAJISJEVE DHE
MATERIALEVE TE NEVOJSHME PER MONTIMIN E TYRE, TE IMPORTUARA NE
FORMEN E INVESTIMEVE**

Në zbatim të nenit 3, shkronja”g”, të ligjit nr.7675, datë 2.3.1993 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992”Për tarifatat doganore”, me propozim të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përfshirjen nga taksa doganore të të gjithave makinerive, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për montimin e tyre, të cilat importohen për t’u investuar në Shqipëri dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Fusha ku do të bëhet investimi duhet të përfshihet në objektin e veprimtarisë së investorit, gjë që duhet të shkruhet shprehimisht në të gjitha aktet identifikuese të subjektit që investon.

b) Makineritë, pajisjet dhe materialet e nevojshme për montimin e tyre të jenë pjesë e kapitalit themelor të subjektit që investon dhe të importohen vetëm për të realizuar procesin teknologjik në fushën përkatëse ku do të bëhet investimi.

c) Fushat e veprimtarisë ku do të bëhet investimi do të jenë:

- prodhimi, me të cilin do të kuptohet rritja e bimëve ose e kafshëve, përpunimi industrial i lëndëve të para, shfrytëzimi i pësirave natyrore dhe minerare;

-ndërtimi;

-shërbimet në telekomunikacion, në banka, për furnizime me karburant të mjeteve detare, hekurudhore e ajrore dhe ato publike;

-transporti dhe komunikacioni për investime të rikonstruktimit, modernizimit dhe zgjerimit të aeroporteve, porteve detare dhe hekurudhave.

ç) Makineritë, pajisjet dhe materialet e nevojshme për montimin e tyre, të cilat janë përfshiruar nga taksat doganore sipas kriterëve të mësipërme, nuk duhet të riekportohen pa kaluar një periudhë prej 10 vjetësh.

2. Makineritë dhe pajisjet që janë nën regjimin e lejit të përkohshëm, pas përfundimit të këtij regjimi, nëse deklarohen se do të përdoren brenda vendit dhe nëse plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë vendim, përfitojnë përjashtim nga taksat.

3. Ministri i Financave nxjerr udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

4. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.125, datë 16.3.1993, nr.315, datë 30.6.1993, nr.499, datë 10.10.1993, nr.541, datë 15.11.1993, dhe aktet e tjera që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi